(b) në rastin e një ortakërie, që është pronari përfitues i më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të kapitalit të kësaj ortakërie ose që ka të drejtë të kontrollojë përbërjen ose votat e shumicës së drejtuesve të kësaj ortakërie nëpërmjet kompetencave të parashikuara në marrëveshjen e ortakërisë ose çdo dokument tjetër që rregullon punët e kësaj ortakërie, dhe “e Kontrolluar” do të interpretohet sipas rastit. Për këtë qëllim, “personat që do të veprojnë në bashkëpunim”, në lidhje me një person, janë personat që bashkëpunojnë aktivisht sipas një marrëveshjeje ose mirëkuptimi (qoftë formale ose jo formale) për të marrë, ruajtur dhe forcuar Kontrollin e këtij personi.

“Barrë”

është, çdo hipotekë, barrë, peng, opSION, kufizim, e drejtë refuzimi, e drejtë parablerje, e drejtë e palës së tretë ose interes ose barrë tjetër apo e drejtë interesi e çdo lloji, ose çdo marrëveshje tjetër që ka të njëjtin efekt përfshirë çdo gjë të ngjashme me sa më sipër sipas ligjeve të çdo juridiksioni.

“Asambleja e Përgjithshme”

është asambleja e përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

“Administrator”

është secili nga Administratorët e Shoqërisë.

“Qendra Kombëtare e Biznesit”

është *Qendra Kombëtare e Biznesit*, një institucion publik shqiptar, i themeluar me Ligjin Nr. 131, datë 26 nëntor 2015

("Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"), dhe ndryshimi i tij, rast pas rasti.

"Person i Kufizuar"

është çdo person ose subjekt për të cilin është rënë dakord nga palët; ose, sipas gjykimit të arsyeshëm të Ortakëve të tjerë, është ose ka qenë (ose çdo Filial i tij është ose ka qenë) në shkelje të Ligjeve kundër mitmarrjes, Sanksioneve, Ligjeve kundër Pastrimit të Parave ose çdo ligji tjetër dhe ku lidhja me këtë person mund t'i shkaktojë dëm material reputacionit të Ortakut, ndonjë prej Degëve të tij ose Shoqërisë.

"Ortakë"

është, Michael Einter dhe Tobias Steyer, apo në të ardhmen, çdo person fizik dhe/ose juridik zotërues i kuotave në Shoqëri dhe **"Ortaku"** do të interpretohet sipas rastit.

Neni 2 – Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë dhe është e organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 2.2 Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyrat e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të pasohet si më poshtë vijon:
- i. nga fjalët *"Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"* ose *"SHPK"*;
 - ii. numrin e tij unik të identifikimit (NUIS);
 - iii. kapitalin e regjistruar dhe kapitalin e paguar të Shoqërisë;
 - iv. adresën e selisë; dhe
 - v. një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse është e zbatueshme

Neni 3 - Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë kompanisë është në: Rr. Reshit Çollaku, Pallati Classic Construction, H. 2, Kati 2, Nr. 12, Njësia Bashkiake nr. 10, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Çdo Administrator mund të hapë ose mbyllë në Shqipëri adresa dytësore të Shoqërisë

Neni 4 – Emri dhe Afati

- 4.1 Emri i shoqërisë është SWIFT CORPORATE INVESTMENT ALBANIA SHPK.

4.2 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5 – Objekti i aktivitetit

5.1 Veprimtaritë e Shoqërisë do të përfshijnë, por pa u kufizuar në administrimin e aseteve, mbajtjen, investimin, menaxhimin, blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme dhe kuotave të shoqërive (pjesëmarrjet) pa kufizime në industri, zbatimin e zhvillimeve të projektit të pasurive të paluajtshme, etj.

5.2 Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur, Shoqëria mund të:

- kryejë çdo aktivitet me aktive të prekshme dhe të paprekshme, si dhe veprimtari tregtare, qiradhënie ose hipotekore që mund të konsiderohen të përshtatshme ose të nevojshme për të përmbushur qëllimin e Shoqërisë;
- blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe interesa në shoqëri të tjera që kanë një qëllim të ngjashëm me Shoqërinë, në Shqipëri ose jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe
- ushtrojë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i përshtatshëm ose i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë.

5.3 Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo biznes ose aktivitet tjetër që konsiderohet nga Asambleja e Përgjithshme se është zhvilluar ose kryer në mënyrë të përshtatshme ose të favorshme në lidhje me ndonjë nga objektet e mësipërme ose që është menduar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të rritur vlerën ose për ta bërë më fitimprurës cilindo nga aktivitetet e Shoqërisë, pasurinë ose të drejtat e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe në përgjithësi të kryejë të gjitha veprimet e tjera që Shoqëria mund të gjykojë si shoqëruese e ose të favorshme për arritjen e objektivave të mësipërm ose ndonjë prej tyre

KAPITULLI II

KAPITALI; KUOTAT DHE NDRYSHIMI I TË DREJTAVE

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kapitali fillestar i regjistruar i Shoqërisë është 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota (të referuara individualisht si “Kuota” ose bashkërisht si “Kuotat”). Kapitali fillestar përbëhet nga vlera monetare që duhet paguar në një ose më shumë këste brenda vitit të parë, duke filluar nga regjistrimi i shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6.2 Struktura e ortakëve të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortakët	Nr. i kotave	Vlera totale në Kapital	Përqindja në Kapital
Michael Winter	1	300,000 LEK	50 %
Tobias Steyer	1	300,000 LEK	50 %

Neni 7 – Të drejtat

7.1 Kuotat do t'u japin zotëruesve të tyre:

- (i) të drejtën për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë dhe votuar në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe për të ushtruar çdo të drejtë tjetër që lidhet me kuotat sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare; dhe
- (ii) të drejtën për të marrë dividendë ose shpërndarje të tjera në përpjesëtim me vlerën e kuotave në kapitalin e Shoqërisë (nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendime të tilla).

Neni 8 – Kufizimet për Shitjen e Kuotave

8.1 Me përjashtim të parashikimeve të paragrafit 2, asnjë Ortak nuk do të bëjë, ose të pranojë të bëjë, ndonjë nga sa më poshtë vijon pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme:

- a. të shesë, dhurojë, caktojë, transferojë ose japë në ndonjë mënyrë tjetër, ose të japë ndonjë të drejtë/opcion lidhur me ndonjë prej Kuotave të tij ose ndonjë interes ligjor ose përfitues për ndonjë prej Kuotave të tij;
- b. të krijojë ose të lejojë që të ekzistojë ndonjë Barrë mbi ndonjë nga Kuotat tij ose ndonjë interes në ndonjë nga Kuotat e tij;
- c. të krijojë ndonjë *trust* në lidhje me ose të japë ndonjë interes në ndonjë nga Kuotat e tij;
- d. të lidhë ndonjë marrëveshje, të ndërmarrë ndonjë angazhim ose mirëkuptim lidhur me votat ose të drejtën për të marrë dividendë ose çdo të drejtë tjetër që i bashkëngjitet ndonjë prej Kuotave të tij;
- e. të lejojë çdo Person të Kufizuar të fitojë ndonjë interes, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet një ose më shumë filialeve, ose nëpërmjet ndonjë marrëveshjeje që jep një interes ose jep një përfitim i cili rrjedh nga një interes në vetvete ose në ndonjë Shoqëri.

8.2 Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të zbatohet për asnjë transferim të bërë te një Person i Lidhur në çdo kohë që kërkon vetëm njoftimin me shkrim për ortakun tjetër, i cili i dërgohet edhe Shoqërisë.

Neni 9 – Parashikime për Blerjen

- 9.1 Çdo Ortak ka të drejtë të blejë të gjithë Kuotën e Ortakut tjetër. Ortaku i cili synon të zbatojë të drejtën e blerjes do t'i japë një njoftim me shkrim ortakut tjetër. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dhënies së njoftimit me shkrim Ortakut tjetër, të dy Ortakët do të takohen për të diskutuar në mirëbesim se si të zgjidhin çdo mosmarrëveshje për të parandaluar një blerje. Nëse Ortakët nuk bien dakord për parandalimin e blerjes brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita kur Ortakët kanë filluar ose duhet të kishin filluar diskutimet në përputhje me afatin e parashikuar më sipër, secili prej Ortakëve ka të drejtë të bëjë një propozim zyrtar për blerje me kushtet e parashikuara më poshtë.
- 9.2 Ortaku që nis propozimin formal të blerjes ("**Ofruesi**") duhet të propozojë me anë të njoftimit me shkrim një çmim me të cilin do të blejë kuotat e Ortakut tjetër në Shoqëri ("**Marrësi i Ofertës**"). Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dhënies së njoftimit me shkrim, Marrësi i Ofertës ka detyrimin që: (i) të pranojë ofertën për t'i shitur kuotën e tij në Shoqëri Ofruesit me çmimin e propozuar, ose (ii) të bëjë një kundërofertë për të blerë Kuotën e Ofruesit në Shoqëri me një çmim më të lartë. Ortakët mund të vazhdojnë t'i "dërgojnë" kundërofertat njëri-tjetrit për të blerë deri në momentin që njëra nga Palët bie dakord të shesë Kuotën e saj në Shoqëri, me kusht që kundërofertat të mos jenë më të ulëta se vlera e ofertës së mëparshme e rritur me 5%. Mospërgjigja ndaj një propozimi ose kundërofere brenda afatit të përcaktuar përbën pranimin e propozimit ose kundërofertës në fjalë. Pasi blerja të jetë rënë dakord nga Ortaku që vendos të shesë në njoftimin me shkrim, ortakët do të nënshkruajnë një marrëveshje me shkrim për blerjen e kuotave brenda 30 ditëve duke filluar nga dita kur është dhënë njoftimi me shkrim. Pagesa e çmimit do të bëhet jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për blerjen e kuotave, përveç nëse Ortakët bien dakord ndryshe.
- 9.3 Në rast se Ortaku që ka ushtruar të drejtën e tij të blerjes nuk blen kuotat e Ortakut shitës, ky Ortak që nuk e ka përmbushur detyrimin do të humbasë të drejtën e tij të blerjes dhe rrjedhimisht Ortaku tjetër (Ortaku që ka përmbushur detyrimet) do të ketë të drejtë të blejë kuotat e Ortakut me çmimin më të fundit të ofruar për këto kuota nga ortaku që ka përmbushur detyrimet kur ushtron të drejtën e tij të blerjes. Ortaku që ka përmbushur të detyrimet është përgjegjës për përmbushjen e tyre të tij sipas këtij neni dhe në rast se refuzon të vazhdojë me blerjen e Kuotave të Opsionit të Shitjes, kërkohet të paguajë 20% të vlerës së blerjes si një penalitet për mos blerje si dhe të paguajë çdo dëm shtesë, kosto ose shpenzim në lidhje me këtë.
- 9.4 Në rast se Ortaku që ka ushtruar të drejtën e tij të blerjes ("**Ortaku Blerës**") dhe ka nënshkruar me Ortakun tjetër ("**Ortaku Shitës**") një marrëveshje për blerjen e kuotave, i shet një personi të tretë kuotën e blerë për një vlerë që tejkalon çmimin e shitjes me të paktën 25% brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e kuotës, më pas, Ortaku Blerës do të ndajë në mënyrë të barabartë fitimin në kapital të realizuar nga kjo shitje me Ortakun Shitës.

Neni 10 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 10.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.2 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në të gjitha mënyrat dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për aq sa është në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 10.3 Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin pjesë në zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI III


STRUKTURA E SHOQËRISË

Neni 11 – Struktura e Shoqërisë

- 11.1. Shoqëria është e strukturuar me organet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve; dhe
 - b. Administratori(ët).

Neni 12 – Asambleja e Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë dhe ka të drejtë të marrë vendime për të gjitha çështjet e Shoqërisë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë tregtare. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë vlefshmërinë e çdo vendimi të Administratorit(ve), dhe nëse është e nevojshme, t'i anulojë ato në rast papajtueshmërie me Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:
 - a. ndryshimin e Statutit;
 - b. pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit themeltar ose transferimit të kuotave);
 - c. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të themeltar;
 - d. të vendosë për bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
 - e. të themelojë dhe/ose mbyllë degët dhe zyrat e përfaqësimit;
 - f. nënshkrimin dhe blerjen e kuotave në subjektet të tjera ose transferimin ose krijimin e ndonjë barre ose ndonjë detyrimi tjetër mbi ndonjë kuotë të mbajtur nga Shoqëria në ndonjë subjekt tjetër;



- g. të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare nga administratori(ët) dhe ose çdo organ tjetër i Shoqërisë;
- h. të miratojë pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin, planin e biznesit dhe miratojë shpërndarjen e fitimit dhe/ose mbulimin e humbjeve;
- i. emërojë dhe shkarkojë administratorin(ët);
- j. vendosë për rregullat e brendshme të administrimit;
- k. të ngrejë padi kundër administratorit(ve) të Shoqërisë;
- l. të vendosë për shitjen dhe Barrësimin e aktiveve që tejkalojnë pesë për qind të vlerës së aktiveve të Shoqërisë që rezulton nga pasqyrat e fundit financiare;
- m. të përcaktojë shpërblimin e administratorit(ve);
- n. të vendosë për emërimin e ekspertëve kontabël;
- o. miratojë organizimin drejtues dhe administrativ të Shoqërisë;
- p. të vendosë për çdo çështje tjetër, që në bazë të Ligjit për Shoqëritë e Tregtare dhe/ose këtë statut, është në kompetencën e Asamblesë së Përgjithshme.

12.3 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çdo çështje shtesë e cila nuk është në mënyrë të qartë kompetencë e ndonjë organi tjetër sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij Statuti.

Neni 13 – Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

13.1 Thirrja e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

Çdo Administrator mund të thërrasë një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme në çdo kohë. Në çdo rast, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se qershori i çdo viti, për të diskutuar, shqyrtuar dhe miratuar pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë. Ortakët do të mbajnë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në një vend të përcaktuar nga personi/organi i cili thërret mbledhjen, por duke i dhënë mundësinë secilit Ortak të marrë pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike sipas nenit 13.5 më poshtë.

13.2 Njoftimi për Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Njoftimi me shkrim për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do t'i jepet çdo Ortaku të paktën 7 ditë kalendrike paraprakisht, me postë të regjistruar ose me email me faturë dorëzimi, përveç nëse Ortakët miratojnë me shkrim një afat më të shkurtër njoftimi. Ky njoftim do të shoqërohet me një rend dite i cili identifikon në detaje të arsyeshme çështjet që do të diskutohen në mbledhje së bashku me kopjet e çdo dokumenti përkatës dhe vendimet e propozuara të cilat do të diskutohen në mbledhje.

13.3 Kuorumi në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Kuorumi për transaksionet e biznesit në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme (përfshirë një Mbledhje të Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme) do të jetë të më shumë se 30% e Kuotave

të Shoqërisë, për vendime për të cilat kërkohet shumicë e thjeshtë dhe më shumë se 50%e Kuotave të Shoqërisë për vendime për të cilat kërkohet shumicë e cilësuar, sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Nëse kuorumi nuk është i pranishëm brenda 60 minutash nga koha kur mbledhja duhet të kishte filluar ose nëse gjatë mbledhjes nuk ka më kuorum, mbledhja do të shtyhet dhe do të mblidhet në të njëjtën kohë dhe vend gjatë Ditës së Punës e cila është pesë (5) Ditë Pune menjëherë pas datës së propozuar të mbledhjes, përveç nëse të gjithë Ortakët bien dakord me shkrim për një periudhë tjetër ("Mbledhja e Shtyrë e Asamblesë së Përgjithshme"). Njoftimi për Mbledhjen e Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme do t'u jepet të gjithë Ortakëve që mungojnë.

13.4 **Votimi në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

- a. Kryetari i mbledhjes do të emërohet nga ortaku Michael Winter. Sekretari i mbledhjes do të emërohet nga Kryetari dhe mund të jetë noter publik.
- b. Sipas nenit 13.3, vendimi i ortakëve merret me shumicë të thjeshtë votash, me përjashtim të vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare (75% të votave të Ortakëve të pranishëm në mbledhje) pra, ndryshimi i Statutit, shpërndarja e fitimeve, rritja ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ristrukturimi dhe prishja e Shoqërisë. Një shumicë e thjeshtë ose e cilësuar, sipas rastit, do të përcaktohet në përputhje me të drejtat e votës që i bashkëlidhen Kuotave të Ortakëve që marrin pjesë në mbledhje, megjithatë, me kusht që votat abstenuese të mos numërohen.
- c. Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhet nga Kryetari dhe sekretari i mbledhjes. Ekstraktet e vendimeve të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshme të kërkuara për depozitim sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare përgatiten nga Kryetari dhe, nëse është e nevojshme, nënshkruhen nga të gjithë Ortakët e pranishëm dhe që votojnë në mbledhje. Nëse ndonjë nga Ortakët refuzon të nënshkruajë brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e ekstraktit, ekstrakti do të konsiderohet si ekstrakt i vërtetë i vendimeve të marra në mbledhje me nënshkrimin e vetëm të Kryetarit dhe kundër-firmën e sekretarit të mbledhjes.

13.5 **Pjesëmarrja në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

Një Ortak mund të marrë pjesë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme me anë të telefonit, video konferencës ose formave të ngjashme të pajisjeve të komunikimit të cilat u mundësojnë të gjithë Ortakëve në mbledhje të dëgjojnë dhe flasin me njëri-tjetrin gjatë gjithë mbledhjes. Një person i cili merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet të jetë i pranishëm personalisht në mbledhje dhe do të numërohet në kuorum dhe ka të drejtë vote.

13.6 **Vendndodhja e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme**

Nëse të gjithë Ortakët që marrin pjesë në një mbledhje nuk janë në të njëjtin vend, atëherë mbledhja do të trajtohet si e zhvilluar në selinë e Shoqërisë.

13.7 **Vendimi me shkrim i Ortakëve**

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë me anë të një vendimi me shkrim pa thirrur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, me kusht që të gjithë Ortakët të votojnë në favor të këtij vendimi. Njoftimi i një vendimi me shkrim të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme duhet t'i jepet me shkrim çdo Ortaku. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e këtij Statuti, një vendim me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme miratohet kur secili prej Ortakëve ka votuar në favor të këtij vendimi dhe ka nënshkruar një ose më shumë kopje të saj. Pasi të jetë miratuar një vendim me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme, ai do të trajtohet sikur të ishte një vendim i marrë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.


Neni 14 – Administratori

- 14.1 Shoqëria do të ketë një ose më shumë Administratorë, të cilët do të kenë kompetencë n për të menaxhuar individualisht dhe pa kufizime aktivitetet e përditshme të Shoqërisë.
- 14.2 Administratorët, nëse emërohen më shumë se një, do të veprojnë individualisht dhe do ta përfaqësojnë shoqërinë pa kufizim para palëve të treta. Çdo administrator mund t'i delegojë me autorizim ndonjë nga kompetencat e tij administratorit(ëve) tjetër ose ndonjë pale të tretë.
- 14.3 Administratori është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të Shoqërisë që ka marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tij dhe të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Kur një Administrator si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, në kundërshtim me ligjin për shoqëritë tregtare ose këtë Statut i shkakton Shoqërisë një dëm material ose moral, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar.
- 14.4 Kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të çdo administratori, dhe çdo kufizim i tyre, mund të përcaktohen dhe/ose të ndryshohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, të miratuar herë pas here, një ndryshim i tillë nuk do të konsiderohet si një ndryshim i Statutit të Shoqërisë.
- 14.5 Administratori emërohet për një periudhë ose një mandat jo më shumë se 5 (pesë) vjet, siç përcaktohet në vendimin për emërimin e tyre dhe shkarkimi do të vendoset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me shumicë të thjeshtë.
- 14.6 Në çdo rast kur ky Statut i referohet Administratorit, kjo do të konsiderohet si referencë për cilindo nga Administratorët e Shoqërisë nëse është emëruar më shumë se një.

Neni 15 – Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia

- 15.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori (ët) duhet të:
 - a. kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut apo vendimet e Asamblesë së përgjithshme në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë

- në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- b. ushtrojnë kompetencat që u njihen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, ky Statut ose vendimet e Asamblese së Përgjithshme, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këto dispozita;
 - c. vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d. parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
 - e. ushtrojnë kujdesin e duhur të një biznesmeni dhe ruajë fshehtësinë për çështjet konfidenciale;
 - f. sigurojnë çdo informacion në lidhje me të dhënat e biznesit dhe ekonomike të kërkuara nga çdo Ortak brenda një kohe të arsyeshme dhe në çdo rast jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuar.
- 15.2 Administratori(ët) në kryerjen e detyrave të tyre do të mbajnë përgjegjësi ndaj Shoqërisë për një veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyshme me objektin e Shoqërisë, përveç rasteve kur, në bazë të një hetimi dhe vlerësimi të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi ka qenë në mirëbesim.
- 15.3 Në rast shkelje të detyrimeve dhe standardeve të kujdesit që referohen në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni 15, Administratori do të ketë detyrimin për të kompensuar Shoqërinë për çdo dëm që rezulton nga shkelja. Ai/ajo do të kthejë çdo përfitim personal të marrë nga ai apo persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai/Ajo do të ketë barrën e provës për të provuar përmbushjen e detyrimeve të tij dhe standardeve të kërkuara. Kur një shkelje është kryer nga më shumë se një person, të gjithë personat në fjalë do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçmas ndaj Shoqërisë.
- 15.4 Në veçanti, por jo ekskluzivisht, Administratorët janë të detyruar të kompensojnë Shoqërinë për dëmin, nëse kryejnë në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë, këtë Statut ose vendimet e Asamblesë së Përgjithshme transaksionet e mëposhtme:
- a. kthejnë kontributet;
 - b. paguan interesa ose dividendë;
 - c. shpërndan asetet e shoqërisë;
 - d. lejon shoqërinë të kryejë veprimtari kur, sipas gjendjes së saj financiare, është e parashikueshme që ajo nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e saj;
 - e. japë hua



- 15.5 Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohet edhe për kërkesat nga paragrafët më sipër të këtij neni. Këto pretendime duhet të paraqiten brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes ose zbulimi i saj

KAPITULLI IV

CËSHTJET FINANCIARE

Neni 16 – Audituesi

- 16.1 Një auditues i jashtëm i Shoqërisë do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nëse është e nevojshme. Mandati i auditorit, nëse emërohet, duhet të rinovohet çdo vit.

Neni 17 – Librat e Shoqërisë

- 17.1 Shoqëria do të mbajë libra dhe do të përgatisë dokumente që regjistrojnë llogaritë vjetore, pasqyrat financiare, bilancet, raportet financiare dhe çdo dokument tjetër të tillë, siç kërkohet me ligj.
- 17.2 Librat e Shoqërisë dhe pasqyrat financiare vjetore, bilancet dhe raportet financiare, do të mbahen në gjuhën angleze dhe shqipe; dhe të shprehura në euro (EUR) dhe në lekë (ALL).

Neni 18 – Viti Financiar

- 18.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë financiar që përfshin periudhën kohore nga regjistrimi fillestar në Regjistrin Tregtar deri më 31 Dhjetor.

KAPITULLI V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 19 – Njoftimet

- 19.1 Një njoftim i dhënë sipas këtij Statuti

- (a) duhet të jetë me shkrim në anglisht (ose të shoqërohet nga një përkthim i përgatitur siç duhet në anglisht);
- (b) do të dërgohet në vëmendje të personit dhe në adresën ose adresën e e-mailit, të dhënë në këtë statut (ose një adresë tjetër, email ose person që pala përkatëse mund t'i njoftojë palës tjetër); dhe
- (c) do të:




- (i) dorëzohet personalisht; ose
 - (ii) dërgohet me email me konfirmimin e marrjes në dorëzim; ose
 - (iii) dërgohet me letër porosi me kthim përgjigje ose me konfirmimin e dorëzimit; ose
 - (iv) (nëse njoftimi do të dërgohet me postë jashtë vendit nga i cili është dërguar) do të dërgohet me postë ajrore.
- 19.2 Adresat për dorëzimin e njoftimeve njoftohen me email ndërmjet ortakëve pas regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 19.3 Një njoftim konsiderohet se është marrë:
- (a) nëse dorëzohet personalisht, në momentin e dorëzimit; ose
 - (b) në rastin e postës elektronike, në momentin e marrjes së konfirmimit të dorëzimit; ose
 - (c) në rastin e letër porosisë me kthim përgjigje ose konfirmimit të dorëzimit, 48 orë nga data e postimit; ose
 - (d) në rastin e postës ajrore, pesë ditë nga data e postimit; ose
 - (e) nëse konsiderohet se marrja sipas paragrafëve të mëparshëm të këtij neni nuk është bërë brenda orarit të punës (që do të thotë nga ora 9.00 deri në orën 17.30 nga e hëna deri të premten, në një ditë që nuk është ditë pune), kur biznesi fillon punë në momentin e marrjes.
- 19.4 Për të vërtetuar dërgimin, mjafton të vërtetohet se njoftimi është dërguar me email në adresën e emailit të Aksionarit ose, në rastin e postës, se zarfi që përmban njoftimin është drejtuar dhe postuar siç duhet.

Neni 20 - Likuidimi i Shoqërisë

- 20.1 Pas vendimit për prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues dhe përcakton kompetencat e tyre dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për shoqëritë tregtare.
- 20.2 Likuiduesi ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ushtron kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të shoqërisë, të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 21 – Administratorët e parë të Shoqërisë

- 21.1 Administratorët e parë të Shoqërisë të emëruar për një mandat 5 (pesë) vjeçar do të jenë:



1. Z. **Michael Winter**, lindur më 05.07.1974, shtetas gjerman.
2. Z. **Tobias Steyer**, lindur më 27.09.0976, shtetas gjerman.

21.2 Nëse është e nevojshme, Asambleja e Përgjithshme do të konfirmojë çdo emërim të bërë në përputhje me këtë Statut në mbledhjen e saj të pare.

Neni 22 – Dispozitat përfundimtare

- 22.1 Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen për çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht me këtë Statut.
- 22.2 Nëse ndonjë dispozitë e këtij Statuti është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt sipas ligjeve të Shqipërisë, ajo do të konsiderohet e veçuar nga ky statut. Në një rast të tillë, aksionarët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zëvendësuar atë me një dispozitë të vlefshme dhe të detyrueshme, efekti i së cilës është sa më afër efektit të synuar dhe në rast se nuk arrihet marrëveshje, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.


Neni 23 – Hyrja në Fuqi

- 23.1 Ky Statut do të hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe dhe do të hyjë në fuqi dhe do të bëhet i detyrueshëm pas nënshkrimit të tij nga Ortakët. Versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi midis Ortakëve, në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dy versioneve.

Nënshkruar në Tiranë, më 8 shkurt 2022


ORTAKËT

Michael Winter



Michael Winter

Tobias Steyer



Tobias Steyer